



## REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk. II.nr.890/2022

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitia Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses Nëntë Vëllzërit shpk me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson J.O avokat nga Prishtina kundër paditurit Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson me autorizim M.K, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike IV.E.K.nr.625/18 datës 12.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 02.09.2022, mori këtë:

### A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e paditëses Nëntë Vëllzërit shpk me seli në Prishtinë, ANULOHET Aktvendimi IV.EK.nr.625/18 e datës 12.07.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, dhe çështja kthehet në rigjykim dhe rivendosje në Gjykatën Komerciale në Prishtinë-Departamenti për çështje ekonomike

### A R S Y E T I M

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktvendimin e ankimuar IV.EK.nr.625/18 datës 12.07.2021, e ka shpallur veten Jo kompetente në pikpamje lëndore në këtë çështje juridike dhe lëndën e ka dërguar në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil të Gjykatës Themelore në Prishtinë si Departament me kompetenc lëndore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor, ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditëses për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së dhe aplikimit të gabuar të dispozitave ligjore. Aktvendimi i atakuar është kundërligjor dhe i paqëndrueshëm dhe si i tillë duhet të prishet, Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyres zyrtare por edhe shkelje thelbësore të dispozitave të LPK-se nga neni 182.1 për shkak se gjykata gjatë procedurës nuk e ka zbatuar apo e ka zbatuar në mënyrë jo të drejtë ndonjë dispozitë të këtij ligji, kurse kjo ka pas ndikim në nxjerrjen e aktvendimit të ligjshëm dhe të drejtë. Gjykata ka anashkaluar nenin 17 të LPK-së. Paditësi e njofton Gjykatën e Apelit se padin ndaj të paditures e ka paraqitur në gjykat me dt.23.11.2018 para se Ligji mbi gjykatat të hynte në fuqi, dhe në kuptim të kësaj në kohën kur është paraqit padia në kuptim të nenit 13 të këtij ligji, Departamenti për çështje ekonomike i Gjykatës Themelore është kompetent në çështjet-kontestet ndërmjet personave juridik vendor dhe të huaj në çështjet e tyre afariste, andaj paditësi me të drejtë konsideron se Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje ekonomike është kompetent për vendosje lidhur me këtë çështje. Propozojm

që të aprovohet ankesa e paditësit si e bazuar, të anulohet aktvendimi i atakuar dhe qështja ti kthehet Departamentit për qështje ekonomike në rigjykim dhe rivendosje

Përgjigje në ankesë nuk gjendet në shkresat e lëndës

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë në seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, e ekzaminojë aktvendimin e shkallës së parë brenda kufijve, dhe shkaqeve të treguara në ankesë, si dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për qështje ekonomike, me Aktvendimin e ankimuar IV.EK.nr.625/18 datës 12.07.2021, e ka shpallur veten Jo kompetente në pikpamje lëndore në këtë qështje juridike dhe lëndën e ka dërguar në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil të Gjykatës Themlore në Prishtinë si Departament me kompetenc lëndore. Vendimin e vet Gjykata e shkallës së parë e ka bazuar në nenin 19 të LPK-së dhe nenit 16 paragrafi 1 nenp.1 I Ligjit nr.06/L-054 për Gjykatat, dhe se paditësja nuk mund të jetë palë në procedurë sepse nuk e ka statusin e shoqërisë tregtare.

Dhoma e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e qështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (f) e LPK-së,

Kolegji i kësaj gjykate duke vlerësuar pretendimet ankimore të paditëses përkitazi me ligjshmërinë e aktvendimit të atakuar dhe gjendjen e fakteve, ka gjetur se të njëjtat janë të bazuara para se gjithash për faktin se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë prova se si ka ardhur deri te konstatimi se pala paditëse nuk mund të jetë palë në këtë procedurë sepse nuk e ka statusin e shoqërisë tregtare, përderisa në shkresat e lëndës gjenden Formularët e deklaramit vjetor tatimor, të biznesit Nëntë Vëllëzërit shpk me adresë Josip Rela nr.18 hyrja 1 nr.4, NRF 810454215.

Kolegji gjithashtu si fakt vendimtar në këtë qështje juridike ka marrë për bazë ndryshimet ligjore që kanë rezultuar me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, e shpallur ne gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës datë 10 shkurt 2022, i cili Ligj në dispozitën e nenit 13 paragrafi 2, ka përcaktuar qështjet që trajtohen në kompetenc të Departamentit për qështje ekonomike. Andaj duke marrë parasysh edhe objektin e kontestit në këtë qështje juridike, Dhoma e Shkallës së Dytë erdhi në përfundim se Departamenti për qështje ekonomike i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, është kompetent të trajtoj këtë qështje juridike kontestimore.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitës së nenit 209 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së,dhe nenit 13 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
Kom.Dh.Shk.II. nr.890/2022 datë 02.09.2022

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari  
Krenar Berisha